



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

01Nr. 104/02-28699/21
Kaçanik, 16.09.2021

Në bazë të nenit 12.1 dhe nenit 82.3 të Ligjit 03/L-040 –Për Vetëqeverisje Lokale(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/ 04 Qershor 2008), nenit 53 të Ligjit Nr. 05/L- 031- për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 19/16 Qershor 2016) si dhe në bazë të nenit 34.5 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, të Kërkesës së MMPH 04-3097-2/21 të datës 01.09.2021 për rishqyrtim të aktit të Kuvendit të Komunës Kaçanik 01Nr.104/02-21139/21 të datës 30.07.2021, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 16 Shtator 2021, mori këtë:


VENDIM

**PËR ANULIMIN E VENDIMIT 01NR.104/02-21139/21 TË DATËS 30.07.2021 -PËR
NDRYSHIM PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR EMËRTIMIN DHE RIEMËRTIMIN E
RRUGËVE LOKALE PAS SHQYRTIMIT TË ANKESAVE KËRKESAVE DHE
PROPOZIMEVE NGA QYTETARËT E KOMUNËS SË KAÇANIKUT**

1. Me këtë Vendim, ANULOHET Vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr.104/02-21139/21 i datës 30.07.2021, me të cilin është Ndryshuar dhe Plotësuar Vendimi për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale, pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve nga qytetarët e Komunës së Kaçanikut.
2. Anulimi i Vendimit të përcaktuar si në pikën 1 të këtij vendimi bëhet në pamundësi të harmonizimit të aktit në aspektin teknik të kërkuar nga MMPH pas vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të lartcekur sipas kërkesës 04 -3097 -2/21 të datës 01.09.2021 për rishqyrtim të aktit të Kuvendit të Komunës Kaçanik 01Nr.104/02-21139/21 të datës 30.07.2021, harmonizimin e tij me legjislacionin në fuqi.
3. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, mbetet në fuqi Vendimi 01Nr.104/02-1699/20 i datës 31.01.2020- për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve nga qytetarët e Komunës së Kaçanikut.
- 5 Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim dhe mekanizmat tjerë relevantë.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës dhe Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Sekretari i MMPHI-së	
Nga:	Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	Datë: 06.10.2021
Zyrtarët përgjegjës:	Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Gëzim Sahiti, Zv. Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave	Nr.020-1250/83
Lënda:	Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Ministria e Pushtetit Lokal, ka pranuar Vendimin 01 Nr. 104/02-28699/21 për anulimin e Vendimit 01 Nr. 104/02-21139/21 të datës 30.07.2021 për ndryshim plotësimin e vendimit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale pas shqyrtimit të ankesave kërkesave dhe propozimeve nga qytetarët në Komunën e Kaçanikut, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, me qellim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni raportin e vlerësimit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary

Për:	Elbert Krasniqi, Ministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Trim Berisha, ud. Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Ministrinë së Administrimit të Pushtetit Lokal Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	
Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Sabrije Rama, Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit
Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	
Lloji i aktit:	Vendimi 01 Nr.104/02-28699/21, për anulimin e vendimit të Kuvendit të Komunës 01 Nr.104/02-21139/21, datë 30.07.2021, miratuar nga KK Kaçanik.

Të nderuar,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, kompetencës ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet

bazike dhe Shtojcën 1 pika 10 të Rregullores së Qeverisë (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal në vijim:

Vendimi 01 Nr.104/02-28699/21, për anulimin e vendimit të Kuvendit të Komunës 01 Nr.104/02-21139/21, datë 30.07.2021, miratuar nga KK Kaçanik.
--

I miratuar me datë:16.09.2021

I parashtruar për shqyrtim në MAPL me datë:22.09.2021

I dërguar për shqyrtim në MMPHI, me datë: 24.09.2021
--

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës nuk është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, meqenëse, ka vepruar konform vlerësimit të MMPHI-së, Nr. Prot.3097-2/21, datë 01.09.2021, me të cilin Vendimi 01 Nr.104/02-21139/21, për ndryshim plotësimin e vendimit 01 Nr.104/02-36179/19 për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve nga qytetarët e Kaçanikut, miratuar nga KK Kaçanik, është vlerësuar se është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, mbetet në dispozicion të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



01Nr 104/02-21139/21
Kačanik, 30.07.2021

Në mbështetje të nenit 17 pika (o) dhe 40 pika (i) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 24 i Ligjit Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave, të Udhëzimit Administrativ Nr. 14/2019, për Caktimin e Emërimit dhe Numërimit të Adresave për Zonat e Qarkullimit Publik, Ndërtesa, Shtëpi, Objekte dhe Parcela Kadastrale të Lira, të nenit 6.2 (o) e Statutit të Komunës, të nenit 15 pika (i) e Rregullores 01.Nr 7864/08 e Punës së Kuvendit të Komunës, të Shkresës së MAPL 020-1250/16 të datës 22.07.2021, përkatësisht Kërkesës së organit vlerësues të ligjshmërisë-MMPH për harmonizim të aktit 01 Nr. 060/01-17365/21 të datës 30.06.2021, Kuvendi i Komunës Kačanik, në mbledhjen e mbajtur më datë 30 Korrik 2021, merr këtë:

V E N D I M

PËR NDRYSHIM PLOTËSIMIN E VENDIMIT 01.NR.104/02-36179/19 - PËR EMËRTIMIN DHE RIEMËRTIMIN E RRUGËVE LOKALE PAS SHQYRTIMIT TË ANKESAVE, KËRKESAVE DHE PROPOZIMEVE NGA QYTETARËT E KOMUNËS SË KAÇANIKUT

1. Me këtë Vendim, Ndryshohet dhe Plotësohet Vendimi i Kuvendit të Komunës 01.Nr.104/02-36179/19 i datës 29.11.2019 -Për Emërtimin dhe Riemërtimin e Rrugëve Lokale pas Shqyrtimit të Ankesave, Kërkesave dhe Propozimeve nga Qytetarët e Komunës së Kaçanikut si në vijim:
2. Me titullin "Hero" të shpallur nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Malsor Dashi dhe Armend Trena, emërohen rrugët si në vijim:
 - 2.1 Një segment i Rr. "Dëshmorët e Kombit" nga degëzimi i Rr. "Remzi Zharku" deri te degëzimi me rrugën Ekrem Gudaqi emërohet Rr. "Malsor Dashi".
 - 2.2 Rruga "Agim Deva" e cila fillon nga kryqëzimi me rrugën "Komandant Bardhi" deri në kufirin administrativ me Komunën e Ferizajt (Stacionin Hekurudhor), emërohet Rr. "Armend Trena".
3. Në zonën urbane Kačanik, emërohen dhe riemërohen rrugët si në vijim:
 - 3.1 Rr. "Ismet Jashari" të zëvendësohet në Rr "Fahruk Raka";

- 3.2 Segmenti nga vendi Uji i Nxehtë deri te lagja Provoliu të emërtohet Rr. "Ismet Jashari";
4. Në fshatin Biçec, emërohen dhe riemërohen rrugët si në vijim:
- 4.1 Një segment rrugor i Rr. "Fadil Bunjaku" - të zëvendësohet në Rr. "Osman Zharku";
- 4.2 Një degëzim rrugor i Rr. "Sanije Bunjaku" - të zëvendësohet në Rr. "Rexhep Mezini";
- 4.3 Emërtim i ri Rr. "Ushtarët e UÇK"-së - te Hasantë;
- 4.4 Emërtim i ri Rr. "Ali dhe Adem Sallahu";
- 4.5 Rr. "Shahin Palloshi" të zhvendoset - lagjja Palloshi i Poshtëm;
- 4.6 Emërtim i ri Rr. "Mexhid Bekteshi".
5. Në fshatin Gërllicë e Epërme, emërohen dhe riemërohen rrugët si në vijim:
- 5.1 Emërtim i ri Rr. "Gurasi".
6. Në fshatin Doganaj, emërohet dhe riemërohen rrugët si në vijim:
- 6.1 Emërtim i ri Rr. "Aziz Xhokli", rrugë e re.
7. Në fshatin Kaçanik i Vjetër, emërohen dhe riemërohen rrugët si në vijim:
- 7.1 Rr. "Shorra" të zhvendoset.
- 7.2 Emërtim i ri Rr. "Ilmi Topojani".
8. Përshkrimi lidhur me kuptimin e emërtimeve të propozuara në pikët 2-7 të këtij Vendimi është si vijon:
- 8.1 Rr. Malsor Dashi dhe Rr. Armend Trena: Heronj të shpallur nga Presidenti, -Policë të rënë në detyrë;
- 8.2 Rr. Fahrur Raka- Veprimtar;
- 8.3 Rr. Ismet Jashari- Dëshmor;
- 8.4 Rr. Osman Zharku- Veprimtar;
- 8.5 Rr. Rexhep Mezini- Veprimtar;
- 8.6 Rr. Ushtarët e UÇK-së - Ngjarje historike;
- 8.7 Rr. Ali dhe Adem Sallahu- Viktima civile të luftës së fundit;
- 8.8 Rr. Mexhid Bekteshi- Veprimtar;
- 8.9 Rr. Gurasi- Toponim;
- 8.10 Rr. Aziz Xhokli- Veprimtar;
- 8.11 Rr. Ilmi Topojani- Veprimtar.
9. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes të Mjedisit, në bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës që të bëjë shënimin në sistem dhe në teren të rrugëve në bazë të këtij Vendimi.

10. Me marrjen e këtij Vendimi, Anulohet Vendimi i Kuvendit të Komunës 01 Nr. 060/01-17365/21 i datës 30.06.2021- Për ndryshim plotësimin e vendimit 01.Nr.104/02-36179/19 të datës 29.11.2019- për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale, pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve nga qytetarët e Komunës së Kaçanikut.
11. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit ne Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen zyrtare të Komunës respektivisht pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
12. Për zbatimin e këtij Vendimi do të përkujdesen: Drejtoria Shërbimeve Publike dhe Emergjencës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit, dhe Mbrojtjes së Mjedisit.
13. Me këtë Vendim njoftohen: Institucionet relevante qendrore dhe lokale, Kryetari i Komunës, Drejtoritë Komunale dhe nëpërmjet tyre njoftohen organet tjera relevante, kryetarët e këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane të komunës, Ndërmarrjet Publike, KEDS-i, Policia e Kosovës, Post Telekomit i Kosovës, QKMF-ja, dhe Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA OF KOSOVO
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KACANIK

Data: 15.03.21 Vendi: KASANI
Nr. orig.: 01-104/02-28699 Shtojcë: 1



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRI E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURË
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

Nivelo orig.: 01-104/02-28699
Org. Dret.: -09-
Nr. i fageve: 1
Te Shkruara: 1
Na. Pages: 1

Rel. Prit.: 3097-2/1
Prit. Na.: 1.09.21
Data: 01.09.21
Dahet: 01.09.21
Time: 01.09.21

PRISHTINE / A No. 1

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

HYRËSE-ULAZNA-INCOVA
REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVO / GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Data: 01.09.2021
Nr. i Lendës: 01-020-1250/19
Shtojcë: 1
Vendi: 1

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary

Për:	Elbert Krasniqi, Ministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Trim Berisha, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Ministrinë së Administrimit të Pushtetit Lokal Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
Nga:	Floriqe Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	12.08.2021
Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Sabrije Rama, Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit
Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	
Lloji i aktit:	Vendimi 01 Nr.104/02-21139/21 për ndryshim plotësimin e vendimit 01 Nr.104/02-36179/19 për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve nga qytetaret e Kaçanikut, miratuar nga KK Kaçanik.

Të nderuar,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, kompetencës ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Shtojcën 1 pika 10 të Rregullores së Qeverisë (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal në vijim:

Vendimi 01 Nr.104/02-21139/21 për ndryshim plotësimin e vendimit 01 Nr.104/02-36179/19 për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve nga qytetaret e Kaçanikut, miratuar nga KK Kaçanik.

I miratuar me datë: 30.07.2021

I parashtruar për shqyrtim në MAPL me datë: 05.08.2021

I dërguar për shqyrtim në MMPHI, me datë: 09.08.2021

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.**

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
1.	Vendimi 01 Nr.104/02-21139/21 për ndryshim plotësimin e vendimit 01 Nr.104/02-36179/19 për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve nga qytetaret e Kaçanikut, miratuar nga KK Kaçanik.	MMPHI- AKK, shqyrtoi Vendimin 01 Nr.104/02-21139/21 dhe erdhi në përfundim se thirrja e bazës ligjore në Ligjit Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave duhet të jetë më e specifikuar me nene dhe paragrafë të cilat përcaktojnë mënyrën e vendosjes për emërtime dhe riemërtime të sistemit të adresave brenda një komune, po ashtu, duhet të specifikohet edhe me Udhëzime Administrative të cilat janë nxjerrë nga Ministria me propozim të AKK, për zbatimin e këtij ligji. Sipas Ligjit Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave, Neni 7 Emërtimi i Zonave të Qarkullimit Publik, paragrafi 1, përcakton se: "Vendimi për emrat e zonave të qarkullimit publik, merret nga Kuvendi i Komunës nën juridiksionin e të cilave ndodhen ato." paragrafi 2, përcakton se: "Emrat për zonat e

qarkullimit publik propozohen nga drejtoria komunale përgjegjëse. Emrat vendosen me vendim të Kuvendit të Komunës. Emrat e zonave të qarkullimit publik synojnë të ruajnë vazhdimësinë dhe homogjenitetin në aspektin kulturor dhe historik që synojnë të jenë të propozuara duke marrë në konsideratë procesin konsultativ me komunitetet që jetojnë në zona të veçanta. Emrat e zonave të qarkullimit publik regjistrohen në Regjistrin Komunal të Adresave."

Neni 10 Riemërtimi i Zonave të Qarkullimit Publik,

Paragrafi 1, përcakton se: "Në rast të nevojës për të ndryshuar emrin ekzistues të një zone zbatohen dispozitat e caktuara në këtë ligj për përcaktimin e emrave të zonave të qarkullimit publik." Paragrafi 2, përcakton se: "Kur për shkak të një ndryshimi të kufijve komunal të Republikës së Kosovës, një zonë e qarkullimit publik është caktuar në një tjetër Komunë dhe ka një konflikt me një emër ekzistues, procesi i riemërtimit do të bëhet në pajtim me këtë ligj."

Ndërsa me paragrafin 1.3. të nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 17/2019 për krijimin dhe administrimin e listës alfabetike për emërtime listës rezervë dhe vendosjen e tyre në regjistrin komunal të adresave, është përcaktuar se: "Ndalohe riemërtimi i ZQP në periudhën 10 vjeçare, përveç në rastet e përcaktuara në këtë nen të paragrafit 1.2.". Me rastin e riemërtimit duhet të kihen parasysh kriteret të cilat janë të përcaktuara me këtë dispozitë.

Bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 14/2019, përkatësisht nenin 5, paragrafi 1.4., përcakton se: "Janë të pranueshme dy fjalë për të formuar një emër unik të duhur p.sh.: Rruga Azem

			<i>Galica. Propozimi i emrave që përbëjnë tre apo katër fjalë nuk janë të rekomanduara".</i>
--	--	--	--

Më poshtë gjeni komentet në aspektin teknik rreth emërtimeve në Komunën e Kaçanikut:

Pika	Emri i rrugës	Shënime AKK
2.1	Malsor Dashi	Riemërtim
2.2	Armend Trena	Riemërtim
3.1	Fahruk Raka	Riemërtim
3.2	Ismet Jashari	Mungon lokacioni, nuk mundet të gjendet saktë ku gjendet rruga dhe forma e sajë
4.1	Osman Zharku	Nuk specifikohet cili segment i rrugës, riemërtim
4.2	Rexhep Mezini	Nuk specifikohet cili segment i rrugës, riemërtim
4.3	Ushtarët e UÇK-së	Mungon lokacioni, nuk mundet të gjendet saktë ku gjendet rruga dhe forma e sajë
4.4	Ali dhe Adem Sallahu	Mungon lokacioni, nuk mundet të gjendet saktë ku

		gjendet rruga dhe forma e sajë, rekomandohen emra me një ose dy fjalë
4.5	Shahin Palloshi	Mungon lokacioni, nuk mundet të gjendet saktë ku gjendet rruga dhe forma e sajë, riemërtim
4.6	Mexhid Bekteshi	Mungon lokacioni, nuk mundet të gjendet saktë ku gjendet rruga dhe forma e sajë
5.1	Gurasi	Mungon lokacioni, nuk mundet të gjendet saktë ku gjendet rruga dhe forma e sajë
6.1	Aziz Xhokli	Mungon lokacioni, nuk mundet të gjendet saktë ku gjendet rruga dhe forma e sajë
7.1	Shorra	Mungon lokacioni, nuk mundet të gjendet saktë ku gjendet rruga dhe forma e sajë, riemërtim
7.2	Ilmi Topojani	Mungon lokacioni, nuk mundet të gjendet saktë ku gjendet rruga dhe forma e sajë

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës i propozon Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, që të kërkojë nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimi të kërkesës për rishqyrtim të aktit. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, mbetet në dispozicion të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.